# DËSHMI ARKIVI

**A-478029**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Reagimi për Hysenin ishte i menjëhershëm”, Basha: Rama nuk ka arsye të japë dorëheqjen! |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/29/reagimi-per-hysenin-ishte-i-menjehershem-basha-rama-nuk-ka-arsye-te-jape-doreheqjen/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 06:51:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 06:46:47 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b75aa70d619be7830ebdb4e9b0b4763ba1d80b0b2df6592f8889ab0c74c34adc` |
| TEKSTI | `58fd0cd55ce5c83e2f2cc0f21f6363afb17372b7e3fbf78a2f940be90ac95086` |
| PAMJA | `e74f444390a7acdfd9fca6c371d378ba91be37bfa2b6e724aa4bd2597681b476` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `23b9e1f9ba81ede8e81bfcf26ace4a3bd750f77d8cf28e730df03d41fb12ae34` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c6f9264c70fd67f9aaea8ca8a31d0350f363dc326e3547de2dbe3cea0108618b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/23b9e1f9ba81ede8e81bfcf26ace4a3bd750f77d8cf28e730df03d41fb12ae34`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Reagimi për Hysenin ishte i menjëhershëm", Basha: Rama nuk ka arsye të japë dorëheqjen!

Politikë

Publikuar: 29/09/2026



Eksperti i sigurisë Faik Basha, i ftuar në emisionin "3D" në RTSH, deklaroi se progresi i Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian është një tregues i qartë i funksionimit të institucioneve dhe i përkushtimit të qeverisë. Sipas tij, avancimi në këtë proces kërkon punë të vazhdueshme dhe një lidership të angazhuar.

Gjatë diskutimit, Basha u ndal edhe te debati publik mbi zërat për dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama, duke i cilësuar ato si pretendime pa bazë të krijuara për vëmendje në rrjetet sociale. Ai nënvizoi se mazhoranca ka qenë nxitësja kryesore e reformës në drejtësi dhe krijimit të Prokurorisë së Posaçme (SPAK), me vetëdijen e plotë se ky institucion do të hetonte zyrtarë të lartë pa përjashtim.

*"Zoti Rama, kur e ka hedhur këtë ide për ta krijuar këtë institucion, ka qenë krejt i vetëdijshëm se ky institucion do të gjykojë e do të hetojë personalitete të larta të këtij vendi, të cilët mbajnë apo kanë mbajtur poste në këtë shtet. Ka qenë krejtësisht i vetëdijshëm se SPAK-u do të hetojë si brenda kësaj mazhorance, ashtu edhe jashtë saj,"* u shpreh Basha.

### Ndarja e pushteteve dhe menaxhimi i hetimeve ndaj zyrtarëve

Në analizën e tij, Basha bëri një dallim mes trajtimit të zyrtarëve me mandat publik dhe atyre pa imunitet parlamentar kur përballen me procese hetimore. Ai solli në vëmendje rastin e ish-zëvendëskryeministres Belinda Balluku, e cila u largua nga postet ekzekutive ndërsa vijon hetimi.


## Më të lexuarat


Nga Hati tek prokurori i SPAK, personazhet në videot e Gys Agasit (emrat)


Dosja Sherbimit Sekret: Si i hapte dyert e Portit të Durrësit Liburn Aliu, me urdhër të Vlora Hys...


"Dorëheqja" e Ramës / Nata e Çunit të Fahriut si ministër i Brendshëm dhe pakti me Mulin


Kumbarët e kokainës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi 50 tonë drogë


Shuhet në moshën 40-vjeçare mundësi i njohur, "Pac" kishte dalë në ring vetëm një ditë më parë

*"Zonja Balluku dha dorëheqje nga posti i zëvendëskryeministrit dhe nga posti i ministrit; ajo është në hetim dhe gëzon vetëm mandatin e deputetit. Besoj se deri këtu ishte përplasja për çështjen e pushteteve të ndara, pra ideja që «ti nuk mundesh të më kompozosh mua qeverinë, por unë t'i kam krijuar mekanizmat dhe kam bërë gjithçka që ti të hetosh i lirë, i qetë dhe pa pengesa në detyrën tënde. Ndërsa rasti për personat që nuk kanë imunitet ka vetëm një reagim: në momentin që merresh në hetim nga kjo strukturë, ti menjëherë duhet të lësh detyrën dhe funksionin që ke, dhe ky reagim i kryeministrit ishte i menjëhershëm.,"* deklaroi eksperti i sigurisë.

Lidhur me qëndrimet e kreut të qeverisë mbi rrjedhjen e të dhënave, Basha sqaroi se shqetësimi i ngritur nuk i adresohej drejtpërdrejt Strukturës së Posaçme, por lidhej me nevojën për të adresuar fenomenin e nxjerrjes së informacioneve sekrete në terrenin publik.

TAG: Faik basha

## Të ngjashme



**"Zvërneci", Klosi: Tradhti kombëtare do ishte të mos zhvillohej projekti**



**Reforma Territoriale, çfarë u diskutua te "Ligjet" në seancën e pasdites? Sako kërkon më shumë kompetenca për bashkitë; Qosja mbështet 100 bashki**



**PS: Jo hartës me 100 bashki të PD! Bylykbashi: Shqyrtoni nismën tonë. Manja: Nuk ka kohë, duhet për zgjedhjet**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'


## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.


## Kategoritë

Email: [email protected]
Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena
Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.